



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT

KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr 01/4 prot

Datë 07/01/2018

VENDIM  
Nr 43 datë 27/11/2018

**PËR**  
**MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, BULEVARDI VERIOR I TIRANËS, BASHKIA TIRANË, PËR QËLLIME UJITJE**

Në zbatim të ligjit Nr.111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" të ndryshuar përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2; Vendimit Nr. 416 datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Vendimit nr.5 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit nr.6 datë 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor", me propozim të ABU, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e lejes për hapjen e një pus-shpimi për qëllime ujitje, për subjektin "Bashkia Tiranë", njësi e qeverisjes vendore nga shpuesi profesionist "NORD-COMAT" sh.p.k. Pusi do të hapet ku ndërtohet Bulevardi Verior i Tiranës për mundësinë e furnizimit me ujë për ujitje për lulishtet me këto të dhëna :

**Pusi Nr.S1-2018**

Koordinatat e grykës së pusit të projektuar në sistemin KRGJSH:

X= 484622.151; Y= 4578123.249; Z=113 m

- Kapaciteti i parashikuar 0,5 l/- 0,7 l/s
  - Thellësia e shpimit të parashikuar 200 m
  - Diametri i shpimit të pusit 240 mm
  - Qëllimi i përdorimit Ujitje
2. Mbylljen e çimentuar të pjesës së sipërme të pusit sipas rekomandimeve të SHGJSH.  
3. Ngarkohet ABU Ishëm Erzen për zbatimin e këtij vendimi.  
4. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN**

**SEKRETAR**  
**Dorina ÇAPUNI**

**KRYETAR**  
**Suzana JAHOLLARI**

